

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 15.07.2024*

**15.07.2024  
Ora 12:07**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite projektvendimin “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”. Fjala për zonjën Josifi për prezantimin.

**Znj. J. Josifi:** Përpara jush kemi përcjellë për shqyrtim dhe në vlerësimin tuaj projektvendimin “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”. Bazuar kjo në nenin 19, dhe nenit 92/4, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, që përcakton kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, lidhur me të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore dhe nxjerrjen e akteve administrative akteve administrative në këtë drejtim. Neni 92/4 përcakton monitorimin e fushatës zgjedhore. Në bazë të udhëzimit tuaj nr. 3, datë 3.11.2022, “Për përcaktimin e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 15.07.2024*

kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, kërkohet caktimi i numrit të monitoruesve në çdo zgjedhje dhe për çdo zonë. Për sa më sipër ne kemi sjellë këtë projektvendim që përcakton numrin e monitoruesve të fushatës së sipërpërmendur. Kjo bazuar në numrin e qendrave të votimit në Bashkinë Himarë, Qarku Vlorë, saktësisht tridhjetë e gjashtë qendra votimi, por dhe referuar praktikës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit të kaluar, të datës 14 maj, ku sërish kjo bashki u mbulua nga një monitories në terren për të bërë monitorimin. Për sa më sipër, Brenda kompetencave tuaja, propozojmë shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëhere, ideja është për të caktuar një monitorues për fushatën e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024. Dakrd, vendosim sipas këti propozimi. Çështje të tjera nuk kemi, faleminderit, ditë të mbarë! Seanca mbyllet!

**Vendimi nr. 81**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

